



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2909/ 5 Prot.

Datë 03/11/2025

**V E N D I M**  
**Nr. 1582 /2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                |            |
|----------------|------------|
| Fiorent Zguro  | Nënkryetar |
| Anila Malaj    | Anëtar     |
| Gjergj Mersini | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 03/11/2025 me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomië “ALB-MATRIX GROUP” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-61965-09-18-2025, me objekt: “MONITORIMI GJEODEZIK I DIGAVE TË KASKADËS SË LUMIT DRIN DHE MASIVËVE TË PAQENDRUESHËM GJEOLOGJIK PRANË TYRE”, me fond limit 6.600.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

**Ankimues:** Operatori ekonomik ALB-MATRIX GROUP” SHPK me NIPT: L91616027G, dhe me adresë: Rruga “Isa Boletini” shk.9 /1/A3 / Privat, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)  
Adresa: Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto” Tiranë.

**Baza Ligjore:** Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766,

datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraparak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.09.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-61965-09-18-2025, me objekt: “MONITORIMI GJEODEZIK I DIGAVE TË KASKADËS SË LUMIT DRIN DHE MASIVËVE TË PAQENDRUESHËM GJEOLLOJIK PRANË TYRE”, me fond limit 6.600.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

II.2 Në datën 29.09.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.2 Në datën 03.10.2025 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

|   |                                                                         |           |           |      |              |
|---|-------------------------------------------------------------------------|-----------|-----------|------|--------------|
| 1 | BOE "ALB MATRIX GROUP SHPK & SURVEY SOLUTION SHPK"                      | me ofertë | 4.945.000 | leke | skualifikuar |
| 2 | BOE "INFRATECH SHPK & EMAR 21 SHPK & Engineering Consulting Group SHPK" | me ofertë | 5.214.000 | leke | kualifikuar  |
| 3 | "GJEOKONSULT & CO" SHPK                                                 | me ofertë | 5.600.000 | leke | kualifikuar  |
| 4 | "MCE" SHPK                                                              | me ofertë | 5.800.000 | leke | kualifikuar  |

II.3. Në datën 03.10.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë "ALB MATRIX GROUP SHPK & SURVEY SOLUTION SHPK" është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

*"Ka paraqitur shtojcën 1 Formulari i ofertës ekonomike në kundërshtim me kërkesat e DT: Seksioni I: Udhëzime për operatorët ekonomik pika 8: Formularët e Ofertës dhe Listat e Çmimeve i cili citon si më poshtë: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar; Shtojca 1 - formulari i ofertës ekonomike është paraqitur në emër të vetëm njërit nga anëtarët e BOE. -Nuk ka paraqitur ofertën sipas formatit të caktuar në DT, Shtojca 2- LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT. Nga BOE është paraqitur Shtojca 2- Lista e çmimeve të artikuj sipas formatit të dokumentave të tenderit lloji mallra."*

II.4. Në datën 10.10.2025 Autoriteti Kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraparak të procedurës objekt ankimi në sistemin e prokurimeve elektronike (S.P.E.).

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/5956, datë 17.10.2025 dhe me numër protokoli nr. 2909/2025 prot, datë 20.10.2025 e operatorit ekonomik e operatorit ekonomik "ALB-MATRIX GROUP" SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme e prokurimit.

II.6 Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprahe" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e

zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2909/1 prot., datë 21.10.2025, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme e prokurimit.

II.7. Më datë 22.10.2025, nga autoriteti kontraktor KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare) është protokolluar shkresa me nr.5074, datë 22.10.2025, me objekt “Mbi ankesën për procedurën e prokurimit: ‘MONITORIMI GJEODEZIK I DIGAVE TË KASKADËS SË LUMIT DRIN DHE MASIVËVE TË PAQËNDRUESHËM GJEOLGJIK PRANË TYRE’, NR. REF-61965-09-18-2025”, në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ALB-MATRIX GROUP” SHPK, ku konstatohet se komisioni i shqyrtimit të ankesave pranë autoritetit kontraktor nuk e ka pranuar ankesën me argumentat si më poshtë vijon:

“Në datë 17/10/2025, nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ALB MATRIX GROUP sh.p.k NIPT L9l6l6027G & SURVEY SOLUTION sh.p.k, NIPT M31723040U, është paraqitur Formulari i ankesës në faqen zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik, për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Monitorimi gjeodezik i Digave të Kaskadës së lumit Drin dhe masivëve të paqëndrueshëm gjeologjik pranë tyre”, NR.REF-61965-09-18-2025.

Pasi u njohëm me Formularin e ankesës në faqen zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik, ju bëjmë me dije se:

“Në zbatim të nenit 110 të Ligjit Nr. 162 datë 26/06/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe nenit 97 të VKM Nr. 285, datë 19/05/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ankesa e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ALB MATRIX GROUP sh.p.k NIPT L9l6l6027G & SURVEY SOLUTION sh.p.k, NIPT M31723040U është jashtë afatit.”.

Bazuar në afatet ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 162 datë 26/06/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe VKM Nr. 285, datë 19/05/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, kjo ankesë nuk merret në shqyrtim nga Autoriteti Kontraktor.”.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### **Arsyeton:**

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “ALB MATRIX GROUP” SHPK lidhur me kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se lidhur me afatet e dorëzimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, ashtu sikurse shprehur në Vendimin Nr. 74, datë 25.06.2025, të Gjykatës

Administrative të Apelit, pika III. Vlerësimi i Gjykatës, 31. Për kushtin tjetër formal të padisë, respektimin e afatit ligjor, në të cilin citohet se: “... *Praktika gjyqësore e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. (00-2017-927) 670, datë 30.05.2017, konfirmon të njëjtin qëndrim: "... Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Tiranës e ka zbatuar gabim ligjin për përlllogaritjen e afatit të prerë të ankimit administrativ. Në këtë pjesë të çështjes, Kolegji konfirmon plotësisht bazueshmërinë në ligj të qëndrimit të Gjykatës Administrative të Apelit, se... edhe afatet e parashikuara nga neni 63 i Ligji për prokurimin publik duhet të interpretohet sikur rregullojnë të gjithë ligjet procedurale, sikur neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative apo neni 148, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas gjykatës së apelit, afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...*”, rezulton se ankesa e operatorit ekonomik ankimues në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë me shqyrtimin në themel të pretendimit të ankimuesit.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “ALB MATRIX GROUP” ShPK për skualifikimin e ofertës së dorëzuar prej tij me pretendimin, si në vijim: “*“Ka paraqitur shtojcën 1 Formulari i ofertës ekonomike në kundërshtim me kërkesat e DT: Seksioni I: Udhëzime për operatorët ekonomik pika 8: Formularët e Ofertës dhe Listat e Çmimeve i cili citon si më poshtë: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar; Shtojca 1 - formulari i ofertës ekonomike është paraqitur në emër të vetëm njërit nga anëtarët e BOE. -Nuk ka paraqitur ofertën sipas formatit të caktuar në DT, Shtojca 2- LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT. Nga BOE është paraqitur Shtojca 2- Lista e çmimeve të artikuj sipas formatit të dokumentave të tenderit lloji mallra.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në Shtojcën 1 “**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**” të dokumenteve të tenderit, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

#### **Shtojca 1.**

*(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)*

#### **FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: [shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

- (b) Ne [vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti], nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit].
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

|                                           |  |
|-------------------------------------------|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë</b> _____                         |  |

III.2.2. Në Shtojcën 2 “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT” të dokumenteve të tenderit, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**  
(në rast BOE): \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

| 1                                         | 2                                                        | 3     | 4               | 5                    |       |
|-------------------------------------------|----------------------------------------------------------|-------|-----------------|----------------------|-------|
| Nr.                                       | Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike | Sasia | çmimi për njësi | Çmimi total (3 x 4X) |       |
| 1.                                        |                                                          |       |                 |                      |       |
| 2.                                        |                                                          |       |                 |                      |       |
| 3.                                        |                                                          |       |                 |                      |       |
| 4                                         |                                                          |       |                 |                      |       |
|                                           | <b>Çmimi total</b>                                       |       |                 |                      | _____ |
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |                                                          |       |                 |                      |       |
| <b>TVSH (%)</b>                           |                                                          |       |                 |                      |       |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |                                                          |       |                 |                      |       |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |                                                          |       |                 |                      |       |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |                                                          |       |                 |                      |       |
| <b>Vula</b>                               |                                                          |       |                 |                      |       |
| <b>Datë</b> _____                         |                                                          |       |                 |                      |       |

III.2.3. Nga verifikimi i dokumentacinit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se operatori ekonomik “ALB MATRIX GROUP” SHPK ka dorëzuar ofertën e tij ekonomike me cilësinë e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALB MATRIX GROUP SHPK & SURVEY SOLUTION SHPK”, duke dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

*Marrveshje bashkëpunimi datë 29.09.2025, të lidhur modis operatorit ekonomik “ALB MATRIX GROUP” SHPK dhe operatorit ekonomik “SURVEY SOLUTION” SHPK, të cilët në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar) dhe Dokumentave të Tenderit të hartuara nga Autoriteti Kontraktor - "Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë", deklarojnë se janë dakort të bëjnë bashkimin e Operatorëve Ekonomike të lartpërmendur për procedurën: "Monitorimi gjeodezik i Digave*

të Kaskadës së lumit Drin dhe masivëve të paqendrueshëm gjeologjik pranë tyre" me fond limit 6,600,000 (Gjashtë milion e gjashtëqind mijë) Lekë pa TVSH, ku referuar përcaktimeve të nenit 6 "Veprime të mëtejshme" të kësaj marrveshje kanë përcaktuar si në vijim: "Shoqëria "ALB MATRIX GROUP" sh.p.k, do të kryejë edhe veprimet e nevojshme, do të përfaqësojë anetarët e grupit si për dorëzimin e ofertës, sigurimin e ofertës/ve, të kërkojë dhe të paraqesë të gjithë dokumentacionin e duhur lidhur me prokurimin, të ndjekë mbarëvajtjen e detyrave, të përfaqësojë bashkimin e shoqërive në tender, si dhe kryerjen dhe përfundimin e të gjitha procedurave ligjore të këtij tenderimi përfshirë edhe kryerjen e pagesave që do të bëhen nga autoriteti kontraktor për këtë objekt prokurimi në llogarinë e "ALB MATRIX GROUP".".

Shtojcën 1 "FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE", të plotësuar dhe të nënshkruar nga administratori i shoqërisë "ALB MATRIX GROUP" SHPK, si më poshtë:

#### **Shtojca 1.**

#### **FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

Data: 29.09.2025

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: **REF-61965-09-18-2025**

Për: **KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **ALB MATRIX GROUP SHPK me nipt L91616027G**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt **"Monitorimi gjeodezik i Digave të Kaskadës së lumit Drin dhe masivëve të paqendrueshëm gjeologjik pranë tyre"**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **ALB MATRIX GROUP SHPK me NIPT L91616027G**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **"Monitorimi gjeodezik i Digave të Kaskadës së lumit Drin dhe masivëve të paqendrueshëm gjeologjik pranë tyre"**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **98390000-3** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  - 8. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 9. Njoftimin e Kontrates;
  - 10. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 11. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  - 12. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 13. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 14. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: 4,945,000 Lek [**katër milion e nëntëqind e dyzet e pesë mijë Lek**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: 5,934,000 Lek [**pesë milion e nentëqind e tridhjetë e kater mije**];

|                                           |               |
|-------------------------------------------|---------------|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> | Emiliano Qose |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |               |
| <b>Vula</b>                               |               |
| <b>Datë 29/09/202</b>                     |               |

Shtojcën 2 “*LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT*” të plotësuar dhe të nënshkruar nga administratori i shoqërisë “*ALB MATRIX GROUP*” SHPK, si më poshtë:

Shtojca 2

LISTA E ÇMIMEVE TE ARTIKUJVE

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF-61965-09-18-2025.**

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** ALB MATRIX GROUP SHPK me NIPT L91616027G Lider dhe përfaqësues i BOE dhe SURVEY SOLUTION shpk me Nipt M31723040U, Anëtar i BOE.

Monedha: Lek

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t’u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës

| 1                                                | 2                                                                                                                  | 3                   | 4                             | 5                                     |                                       |                                      |
|--------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|-------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|--------------------------------------|
| Nr.                                              | <b><i>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike</i></b>                                             | <b><i>Sasia</i></b> | <b><i>Çmimi për njësi</i></b> | <b><i>Çmimi total Lek(3 x 4X)</i></b> | <b><i>ALB MATRIX GROUP (80 %)</i></b> | <b><i>SURVEY SOLUTION (20 %)</i></b> |
| 1                                                | <i>Monitorimi gjeodezik i Digave të Kaskadës së lumit Drin dhe masivëve të paqëndrueshëm gjeologjik pranë tyre</i> | 1                   | 4,945,000                     | 4,945,000                             | 3,956,000                             | 989,000                              |
| <b><i>Çmimi Neto pa TVSH</i></b>                 |                                                                                                                    |                     |                               | 4,945,000                             | 3,956,000                             | 989,000                              |
| <b><i>TVSH (20%)</i></b>                         |                                                                                                                    |                     |                               | 989,000                               | 791,200                               | 197,800                              |
| <b><i>Çmimi total me TVSH</i></b>                |                                                                                                                    |                     |                               | 5,934,000                             | 4,747,200                             | 1,186,800                            |
| <b><i>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</i></b> |                                                                                                                    |                     |                               |                                       |                                       |                                      |
| <b><i>Nënshkrimi</i></b>                         |                                                                                                                    |                     |                               |                                       |                                       |                                      |
| <b><i>Vula</i></b>                               |                                                                                                                    |                     |                               |                                       |                                       |                                      |
| <b><i>Datë 29/09/2025</i></b>                    |                                                                                                                    |                     |                               |                                       |                                       |                                      |

III.2.4. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.6. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

- “1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.*
- 2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.*
- 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

III.2.7. Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

- “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të 27 nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të*

*parashikuara në këtë ligj.”.*

III.2.8. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e*

nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.2.9. Në nenin 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Pas afatit përfundimtar për hapjen e ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.

3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.”.

III.2.10. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”.

III.2.11. Në nenin 82 pika 2 dhe 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në

*dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

*Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:*

*i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*

*ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe*

*iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

*Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti*

*kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.*

*3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:*

*a) nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij; Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.*

*b) nëse ka ndonjë mospërputhje të çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij; Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin*

*c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga kjo rregull situata kur shuma në fjalë ka mospërputhje me*

*shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.*

*Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:*

*- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;*

*- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.”.*

*III.2.12. Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:*

*“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.”.*

III.2.13. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kërkesave dhe kushteve për t'u plotësuar nga ofertuesit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesat e vendosura. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. 30

III.2.14. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “ALB MATRIX GROUP” SHPK ka dorëzuar ofertën e tij ekonomike me cilësinë e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALB MATRIX GROUP SHPK & SURVEY SOLUTION SHPK”, të krijuar me Marrveshjen e bashkëpunimi datë 29.09.2025, ku në nenin 6 *“Veprime të mëtejshme”* të kësaj marrveshje të dy anëtarët kanë përcaktuar se përfaqësues i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë është shoqëruia “ALB MATRIX GROUP” SHPK, ku kjo e fundit ka marrë përsipër që të paraqesë edhe ofertën ekonomike, sikurse përcaktohet edhe në nenin 88, pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se peratatori ekonomik “ALB MATRIX GROUP” SHPK me cilësinë e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë të sipërpërmendur ka paraqitur Shtojcën 1 me emërtim **“FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE”** dhe Shtojcën 2 me emërtimin **“LISTA E ÇMIMEVE TE ARTIKUJVE”**, pjesë e ofertës së tij, verehet se operatori ekonomik ka plotësuar të gjitha vëndet të cilat janë të detyruara për tu plotësuar nga operatorët ekonomikë në këto shtojca si dhe janë firmosur dhe vulosur.

Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues ka ofertuar sipas shtojcës 1 dhe 2 të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk ndodhet përpara faktit të mospërmbushjes së kërkesës së autoritetit kontraktor. Në nenin 82 *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”*, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”*, nga verifikimi rezulton se nuk ka ndryshime sa i përketë

përmbajtjes në mënyrë që oferta të konsiderohet e pavlefshme. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues “ALB MATRIX GROUP” SHPK plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor sa i përket përmbushjes së shtojcës 1 dhe shtojcës 2 pjesë e dokumenteve të tenderit. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni gjykon, se nuk jemi në kushtet e mospërputhjes së çmimit për njësi me çmimin total (gabim aritmetik), apo mospërputhjes ndërmjet fjalëve dhe shifrave, të parashikuara në nenin 82, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, gjithashtu nuk jemi as në kushtet e ndërhyrjes në sasi të shërbimit të kërkuar. Neni 92 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcakton qartë, se nga ana e autoritetit kontraktor nuk mund të lejohet ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se për sa kohë që formulari i ofertës së bashku me listën e çmimeve e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues nuk përmban asnjë nga elementët e sipërcituar, nuk mund të konsiderohet ofertë e pavlefshme.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ALB MATRIX GROUP” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## **Vendosi**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ALB MATRIX GROUP” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-61965-09-18-2025,

me objekt: “*MONITORIMI GJEODEZIK I DIGAVE TË KASKADËS SË LUMIT DRIN DHE MASIVËVE TË PAQENDRUESHËM GJEOLLOJIK PRANË TYRE*”, me fond limit 6.600.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*ALB MATRIX GROUP SHPK & SURVEY SOLUTION SHPK*”, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*ALB MATRIX GROUP*” SHPK
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

